

Datë: 16/10/2024

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "DEJVI JET SKI " SH.P.K**

Sot më datë 16/10/2024 ortaku i vetëm vendosi të themeloj Shoqërinë "DEJVI JET SKI " SH.P.K
Z. DEJVI BENDAJ , shtetas shqiptar, atësia MEMO, lindur në VLORE , në 09/08/1986, me banim në
VLORE , madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me numer identifikimi ID. I60809085S.
Ky Statut është nënshkruar me dëshirën e ortakut të vetëm në Vlorë më 16/10/2024, në katër
ekzemplarë origjinalë duke patur fuqi të barabartë ligjore.

ORTAKU

Z. DEJVI BENDAJ

STATUT DHE AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" DEJVI JET SKI " SH.P.K

Vlorë, më 16/10/2024



STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" DEJVIJET SKI " SHPK
EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

NENI 1-Emërtimi shoqërisë

Shtetasi shqiptar:

Z. DEJVI BENDAJ i biri i MEMOS, lindur në Vlorë më 09/08/1986, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, dhe banues në Vlorë, në adresën Rruga Nacionale Vlorë-Fier, Fshati Panaja, Objekt Nr.3/3, Kati 1 me numër ID. 1608090855 është ortak i vetëm e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur " DEJVI JET SKI " sh.p.k.

Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare» i ndryshuar.

NENI 2—Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jete si vijon:


- a) Shërbime Turistike me Motorra Deti dhe agjenci Turistike për të gjitha llojet e tjera të shërbimeve që përfshin ky sektor
- b) Bar- Restorante dhe shërbime cateringu .
- c) Stacione plazhi
- d) Pjesëmarrje me kuota/ aksione në sipërmarrje të ndryshme
- e) Asistencë përfaqësime për marrjen dhe përdorimin e lejeve/ licensave të ndryshme sipas fushave të veprimtarisë
- f) Ofrimi i këshillimeve/ trajnimeve profesionale në hoteleri – turizëm, sociale, marrëdhënie publike dhe ndërkombëtare
- g) Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pronat e lëvizshme ose reale, si dhe çdo aktivitet tregtar, me qira ose hipotekë, që mund të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm për të arritur qëllimin e Shoqërisë;
- h) Tregti të ndryshme përfshirë import dhe eksport të tyre
- i) Të kryejë çdo veprimtari tjetër që mund të konsiderohet e dobishme ose e nevojshme për të arritur qëllimin e Shoqërisë.

NENI3-Kohëzgjatja e veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin tregtar do jetë subjekt i të drejtës shqiptare pa afat të përcaktuar. Me vendim të ortakut të vetëm afati i mësipërm mund të ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.

NENI4-Vula

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortakut



NENI 5- Seliaeshoqërisë

Shoqëria " DEJVI JET SKI " sh.p.k. ka qendrën në Vlorë ne adresën Rruga Nacionale Vlorë-Fier, Fshati Panaja, Objekt Nr.3/3, Kati 1 dhe do te ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Shoqëria mund të krijojë agjenci, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 6- Kapitali iregjistruar

Kapitali i shoqërisë është LEKE 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe është kapital i ortakut të vetëm.
Kapitali është i ndare në 1 kuote me vlere 100.000 lekë (njëqind mijë lekë) dhe zotërohet nga Z. DEJVI BENDAJ.
Kapitali i shoqërisë mund te rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 7-Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

1.Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat qe rrjedhin prej tyre me vendim të ortakut të vetëm mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - c) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakun e vetëm ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
 - d) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.
2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

NENI 8-Ortaku i vetëm

Shoqëria zotërohet nga një ortak dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakut i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investimet e reja;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.



NENI 9-Dreitim dhe administrimi

9.1 Shoqëria tregtare DEIVI JET SKI " sh.p.k. do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakut të vetëm.

Administrator i Shoqërisë " DEIVI JET SKI " sh.p.k. do te jete duke filluar nga data e sotme për një vit në vazhdim (16/10/2024 deri 16/10/2025) do të jetë z. DEIVI BENDAJ i biri i MEMOS dhe MILIKES. Lindur ne Vlore ne date 09.08.1986 dhe banues ne Vlore ne Lادين Rruaga Nationale Vlorë-Fier, Fshati Pannaia, Objekt Nr.3/3, Kati 1 me nr identiteti 1608090855

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

9.3 Ortaku i vetëm mund ta shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

9.4. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakut të vetëm në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008.

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë ne mungesë dhe për llogari të tij.

NENI 10-Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

NENI 11—Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbylLEN më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakut të vetëm të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBLE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve



fiskale pjesa që mbetet l jepet për përdorim Ortakut të vetëm të saj.

NENI 12—Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortaku i vetëm vendos mbi mënyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke lu përcaktuar edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi:
SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.

Administratori regjistror prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 13- Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do l referohet plotësisimeve të bëra nga ORTAKU I VETEM.

Shoqëria " DEVI JET SKI " sh.p.k. do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe normat e këtij statuti. Ky statut nënshkruhet prej ortakut në datë 16/10/2024.

ORTAKU I VETEM

Z. DEVI BENDAJ

Devini Bendaj
